



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

**RREGULLORE
PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E BASHKIMIT OSE NDARJES SË SHOQËRISË
SË SIGURIMIT**

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 109, datë 29.08.2014

**PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e kushteve dhe procedurave për bashkimin dhe ndarjen e shoqërive të sigurimit.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 56, të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

**Neni 3
Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë shoqëritë e sigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtari sigurimi në Republikën e Shqipërisë të përfshira në një operacion bashkimi apo ndarje.

PJESA II BASHKIMI

Neni 4 Kushtet për miratimin e bashkimit

Autoriteti miraton bashkimin vetëm kur plotësohen kushtet e përcaktuara më poshtë:

1. Në rastet e bashkimit me përthithje duhet që:

- a) shoqëria përthithëse të ketë licencë të paktën në klasat e sigurimit të shoqërisë së përthithur sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
- b) shoqëria përthithëse pas procesit të bashkimit, të ketë aktive të mjaftueshme në mbulim të provigjoneve teknike dhe nivelin e kërkuar të aftësisë paguese.

2. Në rastet e bashkimit me krijimin e një shoqërie të re duhet që:

- a) shoqëria e re të plotësojë kushtet për t’u pajisur me licencë për ushtrim të veprimtarisë së sigurimit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; si dhe
- b) të ketë aktive të mjaftueshme në mbulim të provigjoneve teknike dhe nivelin e kërkuar të aftësisë paguese.

Neni 5 Procedurat e bashkimit

- 1. Shoqëritë e sigurimit të interesuara apo kanë si qëllim për t’u përfshirë në një proces bashkimi vënë në dijeni menjëherë Autoritetin pas depozitimit në QKR dhe publikimit në faqen e internetit të shoqërisë, të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- 2. Kërkesa për marrjen e miratimit të bashkimit depozitohet në Autoritet së bashku me dokumentacionin përkatës të përcaktuar në këtë rregullore.
- 3. Regjistrimi i bashkimit në QKR sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” bëhet vetëm pas marrjes së miratimit nga AMF.
- 4. Autoriteti refuzon kërkesën për miratimin e bashkimit nëse shoqëritë e sigurimit të përfshira në operacionin e bashkimit nuk plotësojnë kushtet dhe procedurat e parashikuara në këtë rregullore.

Neni 6

Dokumentacioni që i bashkëlidhet kërkesës për bashkim

Dokumentacioni që i bashkëlidhet kërkesës për bashkim është si më poshtë:

1. Vendimi i asamblesë së aksionarëve të secilës nga shoqëritë që përfshihen në procesin e bashkimit.
2. Marrëveshja e bashkimit.
3. Raporti i bashkimit, i cili përveç sa parashikohet në nenin 216 të Ligjit nr. Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, duhet të përmbajë:
 - a) informacion të mjaftueshëm mbi objektivat që shoqëritë e interesuara për bashkimin duan të arrijnë nëpërmjet bashkimit, përfitimet përkatëse dhe shpenzimet;
 - b) informacione mbi efektet që bashkimi do sjellë në strukturën organizative dhe mbikëqyrëse, dhe personelin e shoqërisë përthithëse apo shoqërisë e re që do rezultojë nga bashkimi dhe veçanërisht ndryshimet që do bëhen në sistemet e kontrollit të brendshëm dhe administrimit të rrezikut, si dhe në programin për zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
4. Projekt statuti i shoqërisë përthithëse ose i shoqërisë së re.
5. Plani për integrimin e sistemeve/programeve të tyre kompjuterike, i cili duhet të përshkruajë:
 - a) fushën, funksionet, procedurat dhe bazat e të dhënave kompjuterike të përfshira në procesin e integrit;
 - b) kohën e nevojshme për secilën fazë të integrit, duke specifikuar veçanërisht kohën për migrimin e bazave të dhënave dhe datat kur do të përfundojë integrimi i portofoleve (prime, dëmeve, etj.);
 - c) njësitë organizative të përcaktuara për kontrollin dhe monitorimin e gjithë procesit të integrit.
6. Pasqyrat financiare të bilancit, të llogarisë fitim/humbje dhe nivelin e provigjoneve teknike të shoqërive në proces bashkimi, hartuar jo më vonë se 3 muaj para datës së mbledhjes së asamblesë.
7. Plan biznesi i shoqërisë përthithëse apo i shoqërisë së re të krijuar, i hartuar sipas nenit 31 (me përjashtim të germave dh), e), g), të pikës 1 të këtij neni), të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
8. Llogaritja e mbulimit të provigjoneve teknike me aktive të përshtatshme, të shoqërisë që del nga bashkimi.
9. Emri dhe logo që shoqëria e re do të përdorë për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit.
10. Kopje të njoftimit që shoqëritë e përfshira në procesin e bashkimit do t’i dërgojnë të siguruarve. Njoftimi duhet të përmbajë të dhëna specifike mbi shoqërinë përthithëse/shoqërinë e re, si p.sh emrin, adresën, adresën e postës elektronike, numrin e telefonit dhe faksit etj.
11. Miratimi i bashkimit nga Autoriteti i Konkurrencës.

PJESA III NDARJA

Neni 7

Kushtet për miratimin e ndarjes

Autoriteti miraton ndarjen vetëm kur plotësohen kushtet e përcaktuara më poshtë:

1. **Në rastet e ndarjes duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese duhet që:**
 - a) shoqëritë pritëse të kenë licence të paktën në klasat e sigurimit të shoqërisë që ndahet, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
 - b) shoqëritë që dalin nga ndarja duhet të kenë aktive të mjaftueshme në mbulim të provigjoneve teknike dhe nivelin e kërkuar të aftësisë paguese.
2. **Në rastet të ndarjes duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e në favor të dy ose me shumë shoqërive të themeluara rishtazi, duhet që:**
 - a) shoqëritë që dalin nga ndarja të plotësojnë kushtet për t’u pajisur me licencë për ushtrim të veprimtarisë së sigurimit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; si dhe
 - b) të kenë aktive të mjaftueshme në mbulim të provigjoneve teknike dhe nivelin e kërkuar të aftësisë paguese.

Neni 8

Procedurat e ndarjes

1. Shoqëritë e sigurimit të interesuara ose që kanë si qëllim për t’u përfshirë në një proces ndarje vënë në dijeni Autoritetin pas depozitimit në QKR dhe publikimit në faqen e internetit të shoqërisë, të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
2. Kërkesa për marrjen e miratimit të ndarjes depozitohet në Autoritet së bashku me dokumentacionin përkatës të përcaktuar në këtë rregullore.
3. Regjistrimi i ndarjes në QKR sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” bëhet vetëm pas marrjes së miratimit nga AMF.
4. Autoriteti refuzon kërkesën për miratimin e ndarjes nëse shoqëritë e sigurimit të përfshira në operacionin e ndarjes nuk plotësojnë kushtet dhe procedurat e parashikuara në këtë rregullore.

Neni 9

Dokumentacioni që i bashkëlidhet kërkesës për ndarje

Dokumentacioni që i bashkëlidhet kërkesës për ndarje është si më poshtë:

1. Vendimi i asamblesë së aksionarëve të secilës nga shoqëritë e përfshirë në procesin e ndarjes.
2. Marrëveshja e ndarjes.
3. Raporti i ndarjes, i cili përveç sa parashikohet në nenin 216 të Ligjit nr. Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, duhet të përmbajë :
 - a) informacion të mjaftueshëm mbi objektivat që shoqëritë e interesuara për ndarjen duan të arrijnë nëpërmjet ndarjes, përfitimet përkatëse dhe shpenzimet;
 - b) informacione mbi efektet që ndarja do sjellë në strukturën organizative dhe mbikëqyrëse, dhe personelin e shoqërive që do rezultojnë nga ndarja dhe veçanërisht ndryshimet që do bëhen në sistemet e kontrollit të brendshëm dhe administrimit të rrezikut, si dhe në programin për zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
4. Projekt statuti i shoqërive pritëse.
5. Plani për integrimin e sistemeve/programeve të tyre kompjuterike i cili duhet të përshkruajë:
 - d) fushën, funksionet, procedurat dhe bazat e të dhënave kompjuterike të përfshira në procesin e integrit;
 - e) kohën e nevojshme për secilën fazë të integrit, duke specifikuar veçanërisht kohën për migrimin e bazave të dhënave dhe datat kur do të përfundojë integrimi i portofoleve (prime, dëmeve, etj.);
 - f) njësitë organizative të përcaktuara për kontrollin dhe monitorimin e gjithë procesit të integrit.
6. Pasqyrat financiare të bilancit, të llogarisë fitim/humbje dhe nivelit të provigjoneve teknike të shoqërive në proces ndarje, hartuar jo më vonë se 3 muaj para datës së mbledhjes së asamblesë.
7. Plan biznesin të shoqërive pritëse, i hartuar sipas nenit 31 (me përjashtim të germave dh), e), g), të pikës 1 të këtij neni), të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
8. Llogaritja e mbulimit të provigjoneve teknike me aktive të përshtatshme të shoqërive pritëse.
9. Emri dhe logo që shoqëritë pritëse do të përdorin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së sigurimit.
10. Kopje të njoftimit që shoqëria që ndahet do t’i dërgojë të siguruarve. Njoftimi duhet të përmbajë të dhëna specifike mbi shoqëritë pritëse si p.sh emrin, adresën, adresën e postës elektronike, numrin e telefonit dhe faksit etj.

PJESA IV

Neni 10

Afati i shqyrtimit të kërkesës për bashkim apo ndarje

1. Autoriteti shqyrton kërkesën për bashkim ose ndarje dhe merr vendim brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës së bashku me dokumentacionin e plotë shoqërues. Kur Autoriteti vëren mangësi në dokumentacionin e paraqitur apo e gjykon të nevojshme, i kërkon shoqërive të sigurimit të përfshira në operacionin e bashkimit apo ndarjes plotësim dokumentacioni dhe informacion shtesë brenda një afati, i cili nuk mund të jetë më shumë se 1 muaj. Në çdo rast, afati i shqyrtimit të kërkesës për bashkim apo ndarje nuk është më shumë se 3 muaj nga data e marrjes së kërkesës.
2. Autoriteti refuzon kërkesën për miratimin e bashkimit apo ndarjes nëse shoqëritë e sigurimit të përfshira në procesin e bashkimit apo ndarjes nuk depozitojnë në Autoritet, brenda afatit të përcaktuar nga ky i fundit, dokumentacionin e plotësuar apo informacionin shtesë.

Neni 11

Përfundimi i licencës

Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit e shoqërive të përthithura apo të ndara përfundon në datën e çregjistrimit në QKR sipas nenit 220 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 12

Dispozitë transitore

Në rastin e shoqërive që kanë filluar procedurat e bashkimit përpara miratimit të kësaj rregulloreje, dispozitat e kësaj të fundit gjejnë zbatim vetëm për atë sa është e mundur në varësi të fazës ku ndodhet ky proces.

Neni 13

Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI